

RELACION SHPJEGUES

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8580, DATË 17.02.2000 “PËR PARTITË POLITIKE”, TË NDRYSHUAR”

Partitë politike, si bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, të bindjeve e të pikëpamjeve ose të interesave të përbashkëta politike, ndikojnë në jetën e një vendi nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhjet dhe përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit.

Partitë politike marrin pjesë në formimin e vullnetit politik të popullit në të gjitha fushat e jetës publike. Ato kanë ndikim në krijimin e opinionit publik dhe të edukatës politike, nxitjen e pjesëmarrjes aktive të shtetasve në jetën politike dhe pjesëmarrjes në zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore, duke qenë kështu alternativat për qeverisjen e vendit.

Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike, të ndryshuar” nisëm e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, vjen në vijim të nismave për despiunizimin e vendit dhe shkëputjen njëherë e mirë nga e shkuara e errët e një regjimi informativ sekret që shkaktoi drama për shumë familje shqiptare.

Për t’u siguruar që historia të mos përsëritet dhe arrijen e paqes sociale si dhe për të respektuar viktimat e regjimit totalitar, duhet që anëtarët, bashkëpunëtorët sekretë të sistemit të mëparshëm të mos të kenë mundësi të jenë pjesë e vendimarrjes, i çfarëdo niveli qoftë ai.

Zbardhja e të vërtetës për personat që kërkojnë të ushtrojnë detyra shtetërore, mbi të gjitha për ata persona që kanë pasur dhe kanë detyra të larta shtetërore, qofshin të zgjedhur apo të emëruar, është jo vetëm një domosdoshmëri, por edhe një simbolikë e fuqishme për të dënuar krimet e të kaluarës dhe në funksion të së tashmes, për krijimin e një shoqërie të bazuar në parimet dhe vlerat demokratike dhe për pajtimin social.

Kjo nisëm krijon premisat e duhura ligjore që anëtarët, bashkëpunëtorët e sigurimit të shtetit, strukturave sekrete dhe spiunët e atij regjimi të mos jenë më pjesë e posteve publike e të mos mbajnë më peng të ardhmen e vendit për interesa të ngushta vetjake e në kundërshtim me parimet e shoqërisë demokratike.

Për këtë arsye nëpërmjet kësaj nisme, propozohet që të ndalohen personat me të shkuar me ish sigurimin e Shtetit që të zgjidhen kryetar në parti politike dhe nëse janë zgjedhur të shkarkohen.

Qenia e kryetarit të partisë politike, në kushtet ndaluese ligjore, parashikohet në projektligj si një nga rastet e ndalimit të regjistrimit të një partie.

Projektligji parashikon që verifikimi të kryhet përpara regjistrimit, ku organet themeluese i kërkojnë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve verifikimin nëse kryetari i zgjedhur i partisë pëfshihet në ndalimet e parashikuara nga ligji nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar”. Vërtetimi negativ i lëshuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është pjesë e dokumentave për regjistrimin e partisë.

Këtij detyrimi ligjor do t’i nënshtrohen jo vetëm ata që duan në të ardhmen të jenë pjesë e funksioneve shtetërore, por edhe atyre që janë aktualisht në pozicione të tilla, pavarësisht nëse e kanë apo jo një certifikatë pastërtie, Bezhani apo Mezini, pavarësisht nëse janë verifikuar më parë nga Autoriteti i Dosjeve apo jo.

Kjo nisëm parashikon se, nëse Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vërteton se kryetari i një partie politike ndodhet në kushtet e ndalimit sipas ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar” i kërkon partisë politike shkarkimin e kryetarit dhe zgjedhjen e një kryetari të ri brenda 2 muajve nga konstatimi.

Në shumicën e vendeve post komuniste diktatoriale personat që kanë shërbyer në funksione politike në regjimet komuniste të këtyre vendeve, që kanë punuar në ‘policinë sekrete’ dhe forcat e shërbimit inteligjent, si dhe individët që kanë bashkëpunuar me këto shërbime, janë subjekte që i nënshtrohen procesit të verifikimit. Këtyre subjekteve iu ndalohet të mbajnë pozicione politike dhe funksione drejtuese në administratën publike, si dhe në shërbimet e inteligjencës dhe policisë. Për më tepër, në Hungari publikohen emrat e të gjithë personave që kanë qenë bashkëpunëtor të strukturave represive të ish-regjimit komunist. Ndërsa Republika Çeke ndjek praktikën e vetë-rregullimit nga partitë politike, ku kandidatët duhet të dorëzojnë certifikatën e pastërtisë së figurës në parti.

Këto ndryshime ligjore mundësojnë që historitë e së shkuarës të diskutohen hapur dhe në bazë të informimit të plotë e objektiv, për të nxjerrë mësimet e duhura me qëllimin për të evituar përsëritjen e regjimeve dhe strukturave sekrete që kanë shkaktuar tragjedi tek të pafajshmit dhe familjet shqiptare.

Për këto raste duhet të kryhet transparencë e plotë dhe pengesat në legjislacionin ekzistues duhet të adresohen me qëllim zbardhjen e të vërtetës sipas vlerave demokratike të drejtësisë si përgjegjësi për brezat e ardhshëm, por mbi të gjitha detyrim për ata që vuajtën nën regjimin e kaluar.

PROJEKTLIGJ

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8580, DATË 17.02.2000 “PËR PARTITË POLITIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike, të ndryshuar” bëhen ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Në fund të nenit 7 shtohet shkronja “ë” me përmbajtjen si më poshtë:

“ë) Kryetari i zgjedhur i partisë vërtetohet se është zgjedhur në kundërshtim me dispozitat ndaluese të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar”.”

Neni 2

Në fund të nenit 9 shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

“Përpara regjistrimit, organet themeluese i kërkojnë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve verifikimin nëse kryetari i zgjedhur i partisë pëfshihet në ndalimet e parashikuara nga ligji nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar”.

Vërtetimi negativ i lëshuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është pjesë e dokumentave për regjistrimin e partisë të parashikuara nga neni 11 i këtij ligji”.

Neni 3

Pas nenit 26 shtohet neni 26/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 26/1

Në rastet kur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vërteton se kryetari i një partie politike ndodhet në kushtet e ndalimit sipas ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar” i kërkon partisë politike shkarkimin e kryetarit dhe zgjedhjen e një kryetari të ri brenda 2 muajve nga konstatimi.

Në rast se me kalimin e afatit dy mujor, partia politike nuk ka zbatuar procedurat statutore për zëvendësimin e kryetarit, ose, sipas rastit, nuk ka zgjedhur kryetarin e ri, atëherë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendos ndalimin e menjëhershëm të veprimtarisë së partisë politike, në përputhje me shkronjën “d” të nenit 26 të këtij ligji.

Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve regjistrohet në regjistrin e partive politike. Kërkesa paraqitet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në sekretarinë e Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Gjykata vendos për pranimin e kërkesës, shpërndan partinë politike dhe e ç’regjistron atë në përputhje me shkronjën “d” të nenit 26 të këtij ligji”.

Neni 4

Dispozitë kalimtare

Organet përfaqësuese të partive politike që janë të regjistruara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e tij i paraqesin kërkesë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për verifikimin e kushteve ndaluese për kryetarin e partisë në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar”.

Me kalimin e afatit prej tre muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, KQZ-ja vendos ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë dhe paraqet kërkesën sipas nenit 26/1 të këtij ligji në sekretarinë e Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Gjykata merr vendim brenda 30 ditëve nga depozitimi i kërkesës.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE

LINDITA NIKOLLA